


Statistika të regjistrimeve në arsim

2024 - 2025

Tiranë, më 08 Gusht 2025: Gjatë vitit shkollor 2024-2025, në arsimin zyrtar në Shqipëri u regjistruan gjithsej 528.602 nxënës dhe studentë, të shpërndarë në nivele të ndryshme të sistemit arsimor:

- 12,5 % në kopshte;
- 47,4 % në arsimin 9-vjeçar;
- 16,9 % në arsimin e mesëm të lartë;
- 0,1 % në arsimin pas të mesëm, jo të lartë;
- 23,1 % në arsimin e lartë.

Fig. 1 Të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë



Arsimi Parauniversitar

Gjithsej, në arsimin parauniversitar janë regjistruar 405.989 nxënës, duke shënuar një rënie prej 2,6 %, krahasuar me vitin e kaluar shkollor. Kjo përfshin:

- 65.914 fëmijë në arsimin parashkollor (–1,2 %);
- 250.617 nxënës në arsimin 9-vjeçar (–2,9 %);
 - 88,1 % në shkolla publike;
 - 48,0 % e tyre janë vajza.

publikim 08/08/2025

Arsimi i lartë

Gjatë vitit akademik 2024-2025, në të gjitha programet e arsimit të lartë u regjistruan 122.613 studentë, duke shënuar një rritje prej 2,1 %, krahasuar me një vit më parë. Ndër ta, 70,9 % ndjekin studimet në institucione publike të arsimit të lartë.

Në ciklin e studimeve “Bachelor”, për të njëjtën periudhë, janë regjistruar 68.080 studentë, duke shënuar një rënie prej 0,8 %, krahasuar me vitin akademik 2023-2024.

Ashtu si në vitin e kaluar, fusha më e preferuar e studimit mbetet “Biznes, administrim dhe ligj”, ku është përqendruar rreth një e katërta e të gjithë studentëve. Ndër fushat e tjera të preferuara janë:

- “Shëndet dhe mirëqenie” me 20,7 %
- “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me 18,8 %

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Statistika të regjistrimeve në arsim](#)

Metodologjia

Nivelet e arsimit në Shqipëri janë të organizuar sipas programeve dhe të klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED 2011, i cili përdoret ndërkombëtarisht në statistikën e arsimit, si në vijim:

- Niveli 0 - Arsimit parashkollor – çerdhe/kopshte
- Niveli 1 - Arsimit fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë
- Niveli 2 - Arsimit mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë
- Niveli 3 - Arsimit mesëm i lartë – Gjimnaz / Profesional / Social kulturor
- Niveli 4 - Arsimit pas të mesmes, jo i lartë
- Niveli 5 - Arsimit i lartë, cikël i shkurtër
- Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent
- Niveli 7 - Master ose ekuivalent
- Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Përkufizime:

Arsimi zyrtar është përcaktuar si arsimi i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar, përmes institucioneve publike dhe private, të njohura (licensuara) nga autoriteti kombëtar arsimor, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij. Arsimi zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pa shkëputje nga puna ose me kohë të plotë (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevojë të veçantë dhe disa pjesë të arsimit për të rritur, shpesh të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor, i cili kryhet në klasat 1 - 5 dhe cikli i lartë ose arsimi mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6 - 9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm i lartë përfshin gjimnazin, arsimin atë social-kulturor dhe arsimin profesional.

Burimi i të dhënave:

Të dhënat e statistikave të arsimit 9 vjeçar, të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit të lartë sigurohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ndërsa të dhënat për arsimin profesional sigurohen nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me peripecitet vjetor.

Të dhënat mbi statistikën e regjistrimeve në arsimin e lartë, *programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata*, për vitin 2024-25 janë paraprahe dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <https://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Bazuar në Udhëzim Nr. 28, datë 16.10.2023, "Për Kushtet dhe Procedurat për Transferimin nga Arsimi i Përgjithshëm (gjimnaz) në Arsimin Profesional dhe Anasjelltas", të dhënat e arsimit profesional për vitet shkollore 2023-24 dhe 2024-25 përfshijnë dhe transferimet e nxënësve nga arsimi i mesëm i përgjithshëm në arsimin profesional gjatë tremujorit të parë të vitit shkollor.